



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.05.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 9 maj 2019.
2. Shqyrtimi nen për nen i projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*Komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Elena Xhina, Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Permeti, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Xhemal Qefalia, Adelina Rista dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Damian Gjiknuri, Elda Hoti dhe Tom Doshi

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjet që kemi në rendin e ditës.

Pika e parë është miratimi i procesverbalit të datës 9 maj 2019. Jeni dakord me procesverbalin? Ka sugjerime? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Data 25 i bie... Ne e kemi bërë betimin më 28. Mos ka ndonjë problem? Në procesverbal thuhet data 25 e në vazhdim të muajit prill.

Ulsi Manja – Jo, procesverbalet janë me data.

Adriatik Alimadhi – Dakord.

Ulsi Manja – Sot, për shembull, po kalojmë procesverbalin e datës 9 maj 2019.

Të hyjnë mediet!

Për pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit të datës 9 maj 2019, nuk ka vërejtje.

Miratohet procesverbali i mbledhjes së komisionit të datës 9 maj 2019.

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, shqyrtimi nen për nen i projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore e këtij projektvendimi është kolegja Vasilika Hysi.

Para se të fillojmë me shqyrtimin nen për nen të këtij projektvendimi, dua të sjell në vëmendjen e kolegëve që ne i kemi miratuar në parim ndryshimet që do t’i bëhen Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë për disa pjesë të saj, si: reflektimi i ndryshimeve kushtetuese dhe transpozimi në dispozitat e Rregullores së Kuvendit të disa propozimeve të ardhura nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste; reflektimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe reflektimi i Kodit të ri të Sjelljes së Deputetëve, që ne e kemi votuar tashmë në Kuvend, por edhe përfshirjen e rekomandimeve në Rregullore të bëra nga raporti i Grecco-s dhe projektit IPA për vitet 2016-2017, të cilat do t’i prezantojë edhe relatorja, kolegja Vasilika Hysi, në vazhdim.

Para se të fillojmë me shqyrtimin nen për nen, duke qenë se disa kolegë të opozitës, por edhe deputetë të caktuar, kanë sugjerime dhe komente për nene të caktuara të kësaj Rregulloreje, unë gjithmonë, me mirëkuptimin e relatores dhe të kolegëve, mendoj të fillojmë me shqyrtimin nen për nen, të votojmë nenet, për të cilat nuk ka sugjerime dhe komente, ndërsa

nenet, për të cilat kolegët kanë ndërhyrje ose duan të bëjnë sugjerime, t'i lëmë të hapura në pritje të ardhjes së riformulimeve përkatëse dhe para votimit në tërësi, të hedhim në votim edhe propozimet që do të bëni ju.

Dakord, zonja Hysi?

Zonja Hysi, do t'ju lutesha të më ndiqni sipas tekstit integral të dakortësuar që ne kemi në tryezë nen për nen.

Vazhdojmë me nenin 1. Këtu është shtuar kreu A/1 me këtë përmbajtje.

Mund të vazhdoni ju, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Çdo rregullore, nga pikëpamja e teknikës legjislative ka disa dispozita të përgjithshme, që mungojnë në Rregulloren aktuale. Janë shtuar konkretisht 4 nene të reja, të cilat përcaktojnë objektin e Rregullores, çfarë rregullon Rregullorja. Në këtë nen përcaktohen të gjithë kapitujt ose krerët që rregullohen në Rregulloren e Kuvendit.

Në nenin e dytë që shtohet është stema, vula dhe logoja e Kuvendit. Të gjithë jemi në dijeni që çdo institucion ka stemën, logon dhe vulën. Edhe ne i kemi këto të tria. Nga një problem, që është konstatuar në praktikë, rezulton që ka pasur një paqartësi kur përdoret logoja e Kuvendit, kur përdoret stema dhe në këtë kuadër është saktësuar që në bazë të legjislacionit në fuqi për stemat, i jemi referuar edhe rasteve kur do të përdoret stema në Kuvendin e Shqipërisë, vula që ka Kuvendi dhe logoja në rastet kur Kuvendi zhvillon aktivitete në bashkëpunim me institucione të tjera, me të tretë, ose kur Kuvendi merr pjesë në aktivitetet e tyre, por nuk është bashkëorganizator. Në këtë mënyrë qartësohen vula, stema dhe logoja e Kuvendit.

Ne kreun e III-ë përcaktohet ku e ka selinë Kuvendi i Shqipërisë, që është Tirana.

E fundit, është një nen i ri që shtohet për mbledhjet jashtë selisë. Kuvendi i Shqipërisë zhvillon shpesh mbledhje në selinë e vet, por mund të ketë edhe mbledhje jashtë selisë së vet, sikurse edhe komisionet kanë një praktikë tashmë të konsoliduar. Komisioni mund të bëjë mbledhje në selinë e Kuvendit, siç jemi ne sot, por edhe jashtë selisë së Kuvendit, në një institucion ose në një rreth. Deri më sot kjo çështje nuk ka qenë e rregulluar. Pra, ka pasur praktikë, por e pabazuar në Rregullore. Kjo tashmë është sanksionuar.

Këto janë 4 nene që shtohen në pjesën që quhet “Dispozitat e përgjithshme”.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi.

Për nenin 1, “Dispozitat e përgjithshme”, që referoi kolegja Hysi, ka ndonjë gjë për të shtuar?

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një mendim ndryshe për sa u takon pikave 2 dhe 3. Është parashikuar që logoja dhe stema të përdoren vetëm në dokumente zyrtare, akte, shkresa, korrespondenca dhe fletëpalosje, ndërkohë që nuk i jepet mundësi deputetit si individ, dhe duhet specifikuar, sepse dokumenti zyrtar protokollohet në Protokollin e Kuvendit, kurse një dokument i deputetit, një shkresë që deputeti u dërgon zyrave të ndryshme drejtpërdrejt nga zyra e tij në zonën e tij apo çdo gjë tjetër, duhet patjetër të mbajë identifikimin e pozicionit. E kemi katandisur deputetin si nëpunësin më të ulët, më ordiner të këtij shteti. Doni t’i hiqni edhe mundësinë që në shkresat që drejtohet të mos ketë as logon apo stemën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë? Më duket pak e tepruar. Të mos i marrim *mot a mo* këto parashikime nga rregullat e institucioneve që nuk e kanë ndërtimin e tyre si Kuvendi. Kuvendi është një organ kolegjal, ku secili deputet ushtron funksionin edhe individualisht. Prandaj, në këtë pikë, kërkoj të shtohen fjalët “ose nga korrespondenca individuale e deputetit”.

Ulsi Manja – Në çfarë rruge do ta formalizojë deputeti, që në zonën e vet, atje ku është deputet, t’u drejtohet institucioneve lokale me logon e Kuvendit, pa vulën e Kuvendit?

Alket Hyseni – Deputeti mund t’u drejtohet të gjitha institucioneve në zonën e vet, bashkisë dhe institucioneve të tjera, mund të kërkojë informacione edhe sipas kësaj Rregulloreje, të cilat jo domosdoshmërisht duhet të kalojnë në Protokollin e Kuvendit.

Për sa u takon pyetjeve që iu bënë ministrave, Këshillit të Ministrave dhe institucioneve kushtetuese, ai kalon nëpërmjet Rregullores së Kuvendit, por nuk mund të kalojë çdo komunikim i deputetit, përndryshe zyrat që janë atje, pas statusit të deputetit... Deputeti ka të drejtën e zyrës së tij. Çfarë kuptimi ka një zyrë, që qëndron në zonën time elektorale në Sarandë, nëse asistentja që qëndron atje duhet të vijë në Tiranë, të protokollojë letrat, apo vetë deputeti të bëhet postier, të protokollojë letrat, dokumentet dhe më pas t’i nisë atje? Mendoj se edhe sot bëhet komunikim normal. *De facto* është bërë në dhjetëra vite komunikim i deputetëve drejtpërdrejt nga zyrat e tyre, komunikim i thjeshtë, kërkesë për informacione, shqetësime...

Ulsi Manja – Dakord, por duhet të ketë vulë.

Alket Hyseni – Vula është tjetër gjë. Nuk thashë për vulën.

Ulsi Manja – Çfarë të pengon sot ta bësh këtë gjë?

Alket Hyseni – Lexoje parashikimin e Rregullores!

Unë po them për ta bërë me Rregullore, sepse kundër Rregullores është bërë edhe sot. Duhet ta parashikojmë këtu.

Kryetar, pika 2 thotë: “Kuvendi ka vulën dhe logon e vet, të cilat lejohen të përdoren vetëm në dokumente apo shkresa ...”

Ulsi Manja – “... kur ushtrohet veprimtaria parlamentare”.

Alket Hyseni – Çështja është për logon. Edhe për stemën është i njëjti parashikim. “Kuvendi përdor stemën e Republikës së Shqipërisë në mjediset ku ushtrohet veprimtaria parlamentare”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka rëndësi vula. Shkresa është ...

Ulsi Manja – Bëj sa të duash shkresa të tilla.

Alket Hyseni – Vula është një koncept institucioni, jo individ, kurse ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, por duhet të vijë dita.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Nga pikëpamja teknike mund të na ndihmojnë edhe specialistët. Ne jemi 140 deputetë dhe nuk është si një bashki, një ministri apo një drejtori, që përfaqësohet nga drejtuesit, Kryeministri apo kryetari i bashkisë. Ne vërtetë këtu përfaqësohemi nga Kryetari i Kuvendit, por meqenëse deputetët janë gjithëpërfshirës në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe kanë të drejtat e tyre për të dërguar shkresa, siç edhe njëkohësisht marrin shkresa, letra nuk mund të jetë e thatë, që unë, Bashkim Fino, i dërgoj një shkresë Bashkisë Lushnje apo institucionit të një ministrie përkatëse, ku kërkoj disa të dhëna, që më lejon ligji t’i kërkoj, dhe ajo të jetë e thatë, lart e bardhë, me firmën time të njomë dhe pa vulë. Pra, si të thuash, duket si lakuriqe, si e dalë jashtë boje. Ndërkohë, nuk ka asgjë të keqe, siç thotë kolegu ynë, të përdoret logoja. Çfarë është logoja? Ajo që ke ti pas. Logoja përdoret dhe unë jam për më tepër, që të përdoret edhe firma, edhe vula, por nëse vula, unë nuk e di pjesën teknike, atëherë le të shoqërohet nga një shkresë e Sekretarit të Përgjithshëm, për pjesën e vulës, por ama logoja është më se e domosdoshme që ta përdorë deputeti. Pse duhet ta japë letrën e bardhë deputeti? Se këtë nuk arrij ta kuptoj. Këtu kemi të bëjmë me punën intensive të gjithë deputetëve në të gjitha zonat e Shqipërisë. Nuk ka punë intensive çdo punonjës i bashkisë, sepse është kryetari i bashkisë që përfaqëson, është Kryeministri që përfaqëson. Apo një drejtor institucioni. Por ama, ne këtu jemi të barazvlefshëm. Pse jemi të barazvlefshëm? Ne vërtet përfaqësohemi nga Kryetari i Kuvendit, por ne e kemi zgjedhur prej nesh Kryetarin e Kuvendit. Jemi mbledhur në seancën e parë. jemi mbledhur në seancën e parë dhe kemi zgjedhur Kryetarin e Kuvendit,

kemi zgjedhur zëvendëskryetarin e Kuvendit, por le ët themi se jemi të gjithë të barabartë. Nga kjo pikëpamje, logon duhet ta përdorin të gjithë deputetët. S'po bëjnë ndonjë hata!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Pano, modelet. Kemi modele të parlamenteve të rajonit ose të vendeve të BE-së, në lidhje me sa parashtron kolegu Hyseni? Se dakord, logoja është diçka tjetër, vula është diçka tjetër. Ju lutem!

Mimoza Pano – Ky kre është shtuar sipas modeleve që janë marrë nga vendet e BE-së dhe nga vendet e rajonit. Ishte i munguar, dhe kjo është arsyeja që është shtuar. Përdorimi i vulës, i stemës apo i logos, është një teknikalitet i propozuar në këtë mënyrë. Në qoftë se ju vlerësoni se duhet të përdoret logoja edhe nga deputetët në zonat e tyre, mund të votohet.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Gjoni!

Ralf Gjoni – Faleminderit, zoti kryetar!

Ju falënderoj edhe për pjesëmarrjen tonë këtu, pavarësisht se ne nuk kemi të drejtë vote nga grupi parlamentar i pavarur, Rregulloren e Kuvendit e konsiderojmë si jashtëzakonisht të rëndësishme sa i takon funksionalitetin të këtij institucioni bazë të demokracisë shqiptare. Mendojmë se kontributi ynë do të jetë i vlefshëm gjatë këtyre mbledhjeve, për sa kohë që diskutohet Rregullorja.

Unë mendoj se duke sjellë pranë komisionit edhe praktika ndërkombëtare, nga eksperiencia personale në vendet perëndimore, si në Britaninë e Madhe apo në parlamentet e tjera të vendeve të BE-së, jam dakord me zotin Hyseni, por edhe me zotin Fino, që stema dhe logoja e Kuvendit duhet të jetë patjetër në çdo korrespondencë që dërgon deputeti i Kuvendit të Shqipërisë.

Për sa i përket vulës, vulës zyrtare, unë do të sugjeroja që vula është një praktikë që nuk po zbatohet më në shumë vende të BE-së. Për sa kohë që deputeti i Kuvendit dërgon një shkresë, e cila kalon nga protokolli i Kuvendit të Shqipërisë, vula mund të bëhet pjesë e korrespondencës që kalon nga protokolli. Pra, protokolli siguron përdorimin e vulës, por nëse deputeti dërgon në zonën e tij një shkresë, një letër-kërkesë informacioni, drejtuar bashkisë, autoriteteve lokale, dhe këtë e dërgon nga zyra e tij apo nga ana e tij personale, mund të përdoret vetëm stema, pa vulën.

Ky është thjesht një sugjerim nga ana ime, nga praktika ime.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjoni!

Fjalën e ka kërkuar zoti Braho.

Spartak Braho – Lidhur me sugjerimin që bën kolegu, unë them se duhet mbështetur edhe për një arsye tjetër. Deputeti është institucion. Deputeti në vetvete është institucion. Kështu, duke qenë institucion, ka të drejtë të ketë edhe përdorimin e shenjave të veçanta zyrtare, që ka Kuvendi në tërësi.

Tashti, për sa kohë kemi një ligj për vulat, unë mendoj se s'ka nevojë të vihet vula, sepse ligji për vulat ka kërkesa të tjera, por logoja nuk ka arsye të mos përdoret. Kështu që unë jam dakord.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Unë ju dëgjova, të nderuar kolegë! Unë do të sugjeroja që këtë dispozitë ta lëmë të hapur. Është një çështje që ne e kemi diskutuar gjerësisht me grupin e punës, i cili ka punuar bazuar në propozimet e grupeve parlamentare. Ka një ligj për vulat, ka rregulla për vendosjen e stemës. Stema e republikës vendoset në kategori të caktuara shkresash, dhe jo në çdo lloj shkrese. Janë krerët e shtetit dhe të institucioneve. Për sa i përket logos, ajo është logoja që kemi, është pikërisht kjo, të nderuar kolegë, kjo që kemi këtu në sallë, të cilën ne e përdorim për aktivitete të Kuvendit. Sepse, neve nuk na lejohet që në një aktivitet, në një konsultim që bëjmë, në një debat, të përdorim stemën. Edhe unë që jam zëvendëskryetare e Kuvendit, kam rregulla në lidhje me bërjen e shkresave. Kur nis shkresë si deputete, e nis thjesht me firmë, pa vulë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Le ta mbarojë mendimin! Të lutem, të lutem!

Vasilika Hysi – Sepse ka ligj për vulat. Në këtë kuadër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Braho, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Ta mbaroj një çikë! Le ta lëmë hapur...

Ulsi Manja – Le ta mbarojë mendimin relatorja.

Vasilika Hysi – Unë po ju them se janë vetëm krerët e institucioneve. E ka ligji. Ka një ligj të posaçëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë kuadër...

Ulsi Manja – Të lutem, zoti Fino!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, le ta respektojmë njëri-tjetrin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta respektojmë njëri-tjetrin, se nuk po shpikim rrotën këtu.

Vasilika Hysi – Një nga problemet që ka lindur dhe që është detajuar, është keqpërdorimi i stemës dhe i logos. Pra, kur bëjmë aktivitete, kur bëjmë listëprezencë, kur bëjmë dokumente dhe i riprodhojmë për pjesëmarrësit, shpesh vendoset stema.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E para kjo.

E dyta, kolegë, ju të gjithë keni, këtu nuk flas për deputetët e opozitës që janë rishtas në komision, kjo Rregullore ka dy vjet në e-mailin tuaj. Nuk keni pasur mundësi të shpreheshit dhe t'i adresonit këto shqetësime në grupin e punës? Sepse, të paktën unë dhe Ervin Bushati nga grupi, jemi këtu. Katër deputetët e tjerë janë në rrugë, pra s'janë, por unë sugjeroj ta lëmë të hapur. Nëpërmjet Shërbimeve të Kuvendit, t'i referohet ligjit për vulat.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, sepse nuk kemi pse humbim shumë kohë.

Ka një propozim të kolegut Hyseni, dhe ka një sugjerim të relatores, që këtë nen ta lëmë të hapur, ta konsultojmë edhe me aktet e tjera, me praktikatat e tjera që kemi, me qëllim që të bëjmë diçka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Parimisht, jam edhe unë dakord që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, ta mbaroj idenë! Le ta lëmë të hapur, ta konsultojmë edhe me praktikatat e tjera parlamentare, por pse jo edhe me legjislacionin tjetër. S'ka asgjë të keqe që, përpara se ta votojmë në tërësi, të reflektojmë ose të marrim në konsideratë edhe propozimin e zotit Hyseni.

Fjala për ju, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Jam dakord! Le ta lëmë të hapur, se mund të ketë edhe shumë dispozita të tjera, të cilat nuk i mbyllim dot sot. Sa për të iluminuar ndonjë nga kolegët që nuk e di, mund të them se në korrespondencën e tij, edhe në korrespondencën elektronike, çdo parlamentar i Bashkimit Europian përdor logo. Ju lutem, referojeni në e-mailin tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Profesoreshë, ju lutem mos më ndërprisni!

Po ju lexoj pikën dy, të propozuar nga ju. Thoni: “Kuvendi ka vulën e vet, si dhe logo, të cilat lejohen të përdoren vetëm në dokumente”, thua, e më poshtë vijon: “të nënshkruara nga titullarët e autorizuar”.

Tani, logo po kërkoj unë, minimalisht; nuk duhet të jetë vetëm e titullarëve.

Për të bërë sqarimin: jo vetëm kaq, por edhe shkresat. Unë kam komunikim me deputetë anglezë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me firmë është, por me logo. Ai thotë: Parlamenti britanik, grupi parlamentar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, po e them ndryshe. Grupi Parlamentar X, dhe deputeti.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Bashkim Fino – Kur ti, zoti Ulsi, apo unë, Fatmiri apo një tjetër, bëjmë

kartëvizitën e deputetit, vëmë logon e Kuvendit, vëmë numrin e telefonit, e-mailin, njërin e tjetrën, dhe e përdorim.

Pse në rastin konkret e përdorim jashtë ligjit dhe jashtë Rregullores? Pse zonja, që është nënkryetare, e jep kartëvizitën me këtë logo? Kush ia jep të drejtën asaj të përdorë logon e Kuvendit, kur në Rregullore thuhet jo? Pra, që do të thotë se logoja nuk është asgjë. Unë mund të marr letra formati A4...

Ulsi Manja – Po pse duhet të ketë kaq debat kjo gjë, të lutem!?

Bashkim Fino – Unë mund të marr letra formati A4 me logo, t’i mbush vetë

dhe t’i shpërndaj në zonën time elektorale. Ku është shkelja këtu, në qoftë se unë përdor vulën e institucionit, që është më zyrtare? Sepse me logo s’ka asgjë. Në fletë e bardhë me logo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhe e fundit që kam...

Ulsi Manja – Po flasim për stemën dhe logon.

Bashkim Fino – E fundit që kam, dhe s’flas më, se do iki. Sepse, me sugjerimin që na bëri zonja zëvendëskryetare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di çfarë më tha qëparë? Më tha: meqenëse ti ke dhënë mendime, meqenëse e kemi diskutuar, dhe unë jam një nga ata që kanë dhënë mendim në lidhje me këtë Rregullore, nuk ke

të drejtë të flasësh më. Duhet të flasë Ralfi, që erdhi i ri. Po është puna kështu, atëherë unë po e mbyll. E kam bërë draftin, po iki. Punoni me Ralfin. Më fal që po ta përdor emrin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Punoni me këta që janë të rinj dhe miratonjeni Rregulloren! Ju thoni: “Mos flisni më tani, se e kemi miratuar një herë”.

Ulsi Manja - Po, zoti Alimadhi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Unë po u referohem pak eksperiencave tona. Po ju them se të gjitha shkresat që dalin nga institucionet e drejtësisë, prokurorë, gjyqtarë të ndryshëm pasi zbardhin vendimin, i vënë firmën, por logoja është lart. Habitem sesi nuk mundet të vendoset te institucioni i Kuvendit. Nuk e di. E mbështes plotësisht.

Ulsi Manja- Faleminderit!

E ka kërkuar fjalën zoti Xhafaj për një sugjerim.

Fatmir Xhafaj - Po bëjmë kot debat te kjo pikë. Këtu po bëhet fjalë për stemën dhe logon e Kuvendit si institucion. Duhet një dispozitë e veçantë ku të thuhet: “Komunikimi i deputetit”. Tek ajo dispozitë mund të thuhet si e ka kartvizitën, *e-mail*-in deputeti, si dhe çfarë përdor deputeti. Kjo është për institucionin. Kjo është stema, logoja që përdor institucioni. Pra, çfarë i njeh Rregullorja, institucionit dhe atyre që flasin në emër të institucionit.

Pastaj edhe për deputetin të shtojmë një nen të veçantë ku të rregullojmë se si mund t’i ketë këto. A mund të jenë në Rregullore apo do t’ia lëmë Byrosë së Kuvendit t’i përcaktojë këto? Pasi nuk është vetëm komunikimi me shkresë, tani më së shumti është edhe komunikimi elektronik. Pra, do një përcaktim të veçantë dhe nuk është te kjo.

Ulsi Manja - Faleminderit zoti Xhafaj!

E hedhim në votim nenin 1 Dispozitat të përgjithshme.

Neni A/1. Objekti

Zonja Hysi, a jemi dakord me këtë?

Kush është dakord me nenin A/1, që ka të bëjë me objektin? Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet nenin A/1. Objekti.

Lidhur me nenin A/2, ku flitet për stemën, vulën dhe logon e Kuvendit ta lëmë të hapur. Ka dy propozime: një i kolegut Hyseni, i zotit Fino dhe i kolegëve të tjerë, por edhe një propozim konkret i zotit Xhafaj që ta mbajmë nenin “A” 2 siç e kemi për stemën, vulën dhe logon e Kuvendit për institucionin, si dhe të kemi një formulim të qartë lidhur me temën, logon dhe atributet e tjera që do të ketë deputeti. Jeni dakord?

Kalojmë te neni A/3 Selia e Kuvendit”

Zonja Hysi, dakord?

Vasilika Hysi – Dakord për nenin A/3.

Ulsi Manja - Neni A/3. “Selia e Kuvendit është në Tiranë”. Kush është dakord? Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni A/4. “ Mbledhjet jashtë selisë”

E shpjegoi kolegia Hysi. Ju lutem edhe një herë!

Vasilika Hysi - Neni A/4. bën fjalë për mbledhjet që mund të bëjë Kuvendi ose organet e tij, si dhe mbledhjet që mund të bëjnë komisionet ose nënkomisionet parlamentare. “Kuvendi ose organet e punës së tij mund të mbajnë mbledhje edhe jashtë selisë së Kuvendit. Konferenca e Kryetarëve cakton vendin kur mbledhja e Kuvendit bëhet jashtë selisë. Ndërsa për komisionet parlamentare, për rrjedhojë edhe për nënkomisionet që veprojnë sipas rregullave të komisionit, vendi caktohet nga kryesia e komisionit. Në rastin e nënkomisionit janë kryetari dhe sekretari i komisionit”.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Jeni dakord me nenin A/4 me formulimin përkatës? Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shtimi i fjalës “nënkomisioni” u pranua.

Kalojmë te neni 2. Kreu I, pjesa e parë.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Këtu hyjmë në pjesën e Rregullores që është në fuqi dhe aktualisht këto nene në Rregulloren aktuale grupohen te kreu: “Dispozita paraprake”. Titulli i kreut ndryshon, sepse këtu bëhet fjalë për konstituimin e legjislaturës së Kuvendit. Përveç ndryshimit të titullit të kreut, të pjesës së parë ka ndryshime në disa nene. Konkretisht, në nenin 7 të këtij kreu...

Ulsi Manja - Ju lutem, zonja Hysi!

Të miratojmë titullin, pastaj të vazhdojmë me secilin nen.

Propozohet ndryshimi i titullit të kreut I, pjesa e parë. Ky kre titullohet “Dispozita paraprake” në Rregulloren ekzistuese. Meqenëse i gjithë kreu flet për konstituimin e legjislaturës së Kuvendit grupi i punës dhe relatorja propozojnë që të jetë ky titulli: “Konstituimi i legjislaturës së Kuvendit”. Jemi dakord?

Kalojmë në votim? Kush është pro me nenin 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3, që ndryshon nenin 7.

Vasilika Hysi - Neni 3 ndryshon nenin 7 bën fjalë për Kryetarin e Kuvendit dhe kompetencat e tij. Në nenin 7 të Rregullores shtohet një pikë e re, pika 3/1, ku thuhet: “Kryetari i Kuvendit në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare përcakton anëtarësinë në grupet e miqësisë me parlamentet e vendeve të tjera, në bazë të përzgjedhje së bërë nga vetë anëtarët e Kuvendit”. Për këtë pikë dua të theksoj se ka një mangësi në Rregullore, pasi Rregullorja deri sot rregullon përbërjen e delegacioneve të përhershme të Kuvendit pranë organizatave ndërkombëtare, ndërkohë që në parlament ne kemi edhe grupet e miqësisë me parlamentet e vendeve të tjera dhe ky problem nuk është i rregulluar. Pikërisht rregullohet përbërja e anëtarësisë në grupet e miqësisë me parlamentet e vendeve të tjera.

Po në këtë nen, i cili ka 4 pika, shtohet një pikë tjetër, pika 5: “Në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tij Kryetari i Kuvendit nxjerr urdhra dhe udhëzime”. Kryetari realisht nxjerr urdhra, sepse miraton rendin e ditës, thërret mbledhjen, Këshillin e Mandateve e të tjera, por ne nuk e kishim të rregulluar në Rregullore. Ky është një propozim, i cili ka ardhur nga shërbimet e Kuvendit.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Gjatë gjithë Rregullores kam vënë re një mungesë. Kjo Rregullore duhet të shprehet lidhur me deputetët që janë jashtë grupeve parlamentare. Gjatë gjithë kohës flet vetëm për deputetët që janë brenda grupimeve. Mendoj se ndoshta te neni 7, në pikat 3 dhe 4 ku flitet për një shpërndarje të deputetëve në grupet e miqësisë dhe më pas në delegacione, të shtohet një pikë ku të shprehem se Kryetari i Kuvendit në çdo vendimmarrje, duhet të përfshijë edhe deputetët jashtë grupeve parlamentare. Ky është propozimi.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Sigurisht që përbërja e parlamentit përfshin jo vetëm deputetë që bëjnë pjesë në një grup parlamentar, por ka edhe deputetë të pavarur, të cilët edhe ata kanë të drejtën të jenë pjesë përbërëse e delegacioneve apo e grupeve të miqësisë.

Zonja Pano, kjo pikë duhet të rregullohet edhe me deputetët e pavarur.

Zonja Hysi, mund të shtohet te pika 3/1 e nenit 7.

Vasilika Hysi - Po. Do të shtohet te pika 3/1. Lidhur me përbërjen e delegacioneve do të doja edhe vlerësimin e shërbimeve të Kuvendit, sepse në përbërjen e delegacioneve thuhet

se mbahet parasysh përbërja politike në Kuvend, por nuk mbahet parasysh kur një deputet ose deputete është e veçantë.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Po, zonja Pano.

Mimoza Pano - Në fakt, nuk e ka Rregullorja aktuale një parashikim për sa u përket deputetëve që janë jashtë grupeve. Nuk mund të themi “të pavarur”, por deputetë “jashtë grupeve parlamentare”. Përderisa nuk e ka, ndoshta mund ta shikojmë te ky nen dhe të ecim me këtë logjikë në të gjitha nenet e tjera të Rregullores.

Uli Manja- Faleminderit!

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni - Në angazhimet e mia të mëparshme jemi marrë shumë me punën e grupeve të miqësisë, sesi funksionon përbërja dhe kryesimi i tyre. Nëse më lejohet kam një sugjerim: një nga problemet më të mëdha të Kuvendit të Shqipërisë në vite ka qenë mosfunksionimi i grupimeve parlamentare të ngritura për një çështje me interes të caktuar. Ne kemi parimin dhe konceptin e një grupi të miqësisë ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe një parlamenti tjetër, por nuk ekziston koncepti siç ekziston në disa vende të tjera të BE-së, ku të kemi një grup parlamentar gjithpartiak për një çështje interesi të caktuar, për shembull, Grupi Parlamentar për të Drejtat e Fëmijëve, Grupi Parlamentar për Teknologjinë, sepse, në fund të fundit, Kuvendi i Shqipërisë është i detyruar që të marrë parasysh edhe shqetësimet e grupeve të interesit për industritë e caktuara dhe një grup parlamentar mund të sugjerojë për bujqësinë apo për turizmin. Pse të mos ekzistojë një koncept i tillë në Rregulloren e Kuvendit që ne ta shtyjmë këtë lloj axhende dhe këtë lloj formati të grupeve parlamentare, që mund të përbëhet nga deputetë nga grupe të ndryshme parlamentare për të shtyrë para një çështje të caktuar interesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne i kemi komisionet, por nuk ekziston koncepti i grupimit parlamentar. Për shembull, disa deputetë mund të mbledhen bashkë dhe të bëjnë një grupim për industrinë e turizmit, e cila është...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Ju lutem, ta dëgjojmë zotin Gjoni!

Ralf Gjoni – Kjo e shton edhe pjesëmarrjen e deputetëve të Kuvendit në aktivitete të ndryshme, që nxiten nga grupe të ndryshme interesi. Këtu e kam fjalën kryesisht për të drejta e njeriut, por edhe për industritë kryesore që prekin Republikën e Shqipërisë dhe ekonominë tonë kombëtare.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjoni!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Në fakt, shqetësimi ose rekomandimi që bën kolegu Gjoni ka gjetur rregullim në Rregulloren e Kuvendit, pasi ne kemi rregulluar për herë të parë grupin e deputetëve “Miq të fëmijëve”. Për shembull, grupin e deputeteve gra, por nuk përjashtohet mundësia që në parlament në varësi problematikave të nevojave të krijohen grupe të posaçme. Pra, për herë të parë e kemi rregulluar dhe kur të vijmë te nenet përkatëse ta shikojmë me vëmendje se si mund të lihet hapësira për të krijuar një kategori tjetër që mund të jetë aktual në një legjislaturë tjetër mund të mos jetë, pra varet nga përparësitë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

(Diskutime pa mikrofon.)

Është parashikuar në dispozitat e mëvonshme .

Hedhim në votim nenin 3 që rregullon nenin 7 edhe me propozimin e koleges Xhina për të përfshirë deputetët jashtë grupeve parlamentare.

Kush është dakord me nenin 3, që ndryshon nenin 7 të Rregullores? Pro?Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te 4, i cili ndryshon nenin 8.

Vasilika Hysi – Faleminderit, kryetar!

Neni 4 , i cili ndryshon nenin 8 ka të bëjë me Byronë e Kuvendit, i cili është një nga organet më të larta të Kuvendit të Shqipërisë.

Në këtë ne ka pasur shumë komente ose rekomandime nga projekti IPA, që Kuvendi i Shqipërisë ka zbatuar me BE-në dhe pikërisht është reflektuar komponenti i tretë që bën fjalë për pavarësinë financiare.

Në këtë nen ka disa ndryshime:

E para, ndryshon pika 1 e këtij neni, duke sjellë një riformulim, të cilin të gjithë kolegët e kanë përpara. Pra, këtu qartësohet që Byroja e Kuvendit të Shqipërisë është organ vendimmarrës për aspektin administrativ dhe financiar të Kuvendit dhe të organeve të tij. Byroja garanton respektimin parimeve të pavarësisë, organizative, funksionale dhe financiare të Kuvendit, si institucioni më i lartë përfaqësues e ligjvënës dhe që bazohet në parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve. Ky është riformulimi për pikën 1.

Gjithashtu, ka edhe një ndryshim në pikën 2, ku saktësohet organizimi i Byrosë: “Byroja e Kuvendit përbëhet nga Kryetari i Kuvendit, zëvendëskryetarët, 2 sekretarë për buxhetin dhe 4 sekretarë dhe drejtohet nga Kryetari i Kuvendit. Përbërja e Byrosë së

Kuvendit pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit”. Deri këtu nuk ka asnjë ndryshim.

“Një zëvendëskryetar duhet t’i përkasë partisë më të madhe të opozitës parlamentare”. Edhe kjo është sikurse është në Rregullore, por është hequr fjalja: “Nuk mund të zgjidhet më shumë se një sekretar nga i njëjti grup parlamentar”, sepse binte ndesh me faktin se Byroja duhet të përcaktojë, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit. Në qoftë se një grup i vogël do të caktonte shumë sekretarë do të binte ndesh me parimin e përfaqësimit politik.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Së pari, pika 2 që do të ndryshojë duhet reflektuar propozimi për shtim sekretariati, gjë e cila nuk është reflektuar. Pra, bëhen 5 sekretarë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te përbërja thuhet: “përbëhet nga 2 sekretarë për buxhetin dhe 4 sekretarë”.

Ulsi Manja – Po, është më poshtë te neni 5.

Alket Hyseni – Ju lutem, më dëgjoni me vëmendje: janë bërë 5 sekretarë, përveç sekretarit të buxhetit, pra gjithsej janë 6.

Pra, këtu thuhet: “Byroja përbëhet nga 2 sekretarë të buxhetit dhe 4 sekretarë”, por, në fakt, këtu duhet “5 sekretarë”. Unë nuk e di se ku është bërë analiza, por kur të shkojmë te neni më poshtë dua të di se cila ka qenë arsyeja e shtesës së një sekretariati për teknologjinë? Në këtë mënyrë i bie që po dublojmë drejtoritë e Kuvendit. Ne nuk duhet të ngatërrojmë sekretariatet me drejtoritë dhe unë do të doja që kjo çështje të ishte shtruar më parë në Byro dhe pastaj të vinte këtu. Ndaj, unë do t’i kërkoja relatores që të dyja këto nene t’i linim të hapura edhe për disa arsye të tjera. Unë mendoj se këto duhen rregulluar në Rregullore për secilin sekretariat. Këtu nuk janë të rregulluara, por është rregulluar vetëm sekretariati për buxhetin me 2 dispozita, ku nuk është e nevojshme fare se pastaj ka edhe një rregullore të miratuar nga Byroja, ndërkohë që të gjitha sekretariatet e tjera nuk janë rregulluar fare në Rregullore. Ndaj, kërkoj mirëkuptimin tuaj që nenin 4 dhe nenin 5 t’i lemë të hapura për një konsultë në Byro, edhe për çështjen e shtesës së sekretariatit, por edhe për të rregulluar sekretariatet e tjera.

Ulsi Manja –Faleminderit!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Në vazhdim të asaj që tha zoti Hyseni, unë e kam nënvizuar me kohë këtë vërejtje. Absolutisht, te pika 2 duhet të ndryshohet termi “4 sekretarë” dhe duhet vendosur

se cilët do të jenë në pjesët përbërëse të buxhetit, përveç dy sekretarëve të buxhetit, që njëri do të jetë i maxhorancës dhe tjetri i opozitës.

Së dyti, meqenëse ky nen është shumë i rëndësishëm, sepse garanton respektimin pavarësisë financiare dhe në qoftë se është vendosur këtu duhet ta realizojmë, do të ishte mirë që deputetët ta votojnë. Kjo do të thotë se buxheti i Kuvendit do të bëhet nga vetë Kuvendi dhe do të bëhet nga kjo Byro, më pas do të kalojë, siç është neni më poshtë, te Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe në fund në parlament si të gjitha buxhetet e tjera është shumë pozitive dhe duhet të realizohet. Por unë mendoj se mbase nuk është e nevojshme të kërkojmë mendim për buxhetin e Kuvendit nga sekretariati për Kërkimet Parlamentare, Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare apo nga sekretariati i Transparencës, Teknologjisë dhe Informacionit, sepse nuk ka kuptim.

Byroja le të ngelet ashtu siç është, por për pjesën financiare, që më intereson më shumë, duhet të ketë njerëz më të specializuar që vërtet e njohin financën dhe që mund të bëjnë një draftbuxhet për parlamentin të shkëputur nga qeveria, sepse kështu duhet kuptuar ky nen, të miratuar në Komisionin e Ekonomisë dhe më pas në Kuvendin e Shqipërisë, siç miratohet buxheti për të gjitha institucionet e tjera. Kjo duhet të qartësohet saktë dhe drejtë.

Më lejoni t'ju them se Kryetari i Kuvendit është post politik, nënkryetarët e Kuvendit janë përsëri poste politike, pa dashur t'i paragjykoj, pra mund të mos jenë të fushës financiare dhe i bie që vetëm dy specialistët e buxhetit ta bëjnë buxhetin. Pra, meqenëse anëtarët e Byrosë janë politikë, pra kryetari dhe anëtarët, të cilët ashtu duhet të jenë, do të ishte më mirë ta shikonim më mirë financën dhe të mos e lëmë në dorë të dy vetave, sepse sekretarët e tjerë unë nuk i shikoj të afrueshëm në mendimet apo gjykimet që mund të japin për buxhetin e parlamentit shqiptar.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Nga shërbimet dhe organet e Kuvendit, unë e di se pavarësia financiare e Kuvendit do të garantohet me ligj të veçantë. Pra, përtej parashikimeve që ne po bëjmë në këtë rregullore, një nga rekomandimet dhe detyrimet që kemi, për të garantuar pavarësinë e Kuvendit si organi më i lartë sipas Kushtetutës, është të kemi një ligj për pavarësinë buxhetore të Kuvendit, të cilin nuk e kemi prej 29 vjetësh. Megjithatë, deri sa të vijë ai ligj, i cili me sa di unë po punohet nga një projekt, ne do të bëjmë rregullimet përkatëse sipas asaj që sugjerojnë edhe kolegët.

Fjalën e ka relatorja.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Falënderoj edhe kolegët për diskutimin që bënë.

Byroja e Kuvendit ka gjithsej 6 sekretarë, dy sekretarë për buxhetin, dhe 4 sekretarë që rregullohen me nenin 5. Konkretisht kemi: sekretariat për Procedurat dhe Votimet, sekretariat për Statusin e Deputetit, sekretariat për Kërkimin Parlamentar, Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare, sekretariat për Marrëdhëniet me Jashtë dhe ajo që është shtuar është sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit.

Zoti Hyseni ka një të drejtë, por, sikurse e dini, projekti i ri që po harton Kuvendi i Shqipërisë me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane, OSBE-ë dhe NDI-së, i ka dhënë një komponent shumë të madh rritjes së transparencës së Kuvendit, jo thjesht nëpërmjet faqes, por edhe nëpërmjet digjitalizimit, ndjekjes *online* të të gjithë konsultimit publik, debateve dhe përdorimit më të gjerë të teknologjisë së informacionit. Struktura e Kuvendit do të rishikohet, prandaj se ku do të jetë ky sekretariat, për këtë është herët të themi, sepse tani ka filluar zbatimin e projektit.

Ejani ta diskutojmë, a do të bëhen 5 sekretariate? Unë nuk e di nëse transparenca do të jetë bashkë me kërkimin, bibliotekën, botimin e kështu me radhë, për këtë nuk jam në gjendje të flas, por mund ta verifikojmë duke folur edhe me sekretarin e Përgjithshëm dhe me raportin e IPA-së, e cila ka lënë një detyrë.

Lidhur me shqetësimin e kolegut Fino, që janë vetëm 2 sekretarë për buxhetin dhe pjesa tjetër nuk ka lidhje me buxhetin, në fakt, në Kuvendin e Shqipërisë do të diskutohet buxheti për të gjithë sektorët, pra jo vetëm organet, por për të gjithë komponentët e tjerë të Kuvendit. Për shembull, sekretariati për Kërkimin Parlamentar dhe Instituti Parlamentar do të jetë prioritet i prioritetëve në këtë 4-vjeçar. Kuvendi i Shqipërisë po ngre Institutin Parlamentar, i cili do të ofrojë kërkime për të gjithë deputetët, sepse ne nuk jemi specialistë në 35 kapitujt me të cilët ne do të negociojmë me Bashkimin Europian.

Edhe për bibliotekën dhe botimet ka buxhet, si për digjitalizimin, për aksesin në bibliotekat e parlamenteve të vendeve të tjera, sidomos në kuadër të kërkimit, do të kemi nevojë për ekspertë, pra Instituti do të marrë ekspertë e të tjera. Pra, ka nevojë për buxhet.

Shqetësimi i zotit Fino është i drejtë, pra a kanë profesionistë këto sekretariate për të bërë buxhetin? Këtë nuk e them dot, por Kuvendi ka drejtor të posaçme të përbërë nga një numër i konsiderueshëm drejtorësh dhe shefa sektorësh që merren me buxhetin, ndërsa sekretariatet përbëhen nga deputetë, nuk flas për pjesën e stafit teknik. Buxhetin e ka për detyrë ta bëjë stafi teknik dhe drejtorët. Në Byro secili nga deputetët do të diskutojë për komponentin e vet, pra kush është te kërkimi dhe kush është tek teknologjia.

Zoti kryetar, ajo që mbetet është shqetësimi i zotit Hyseni lidhur me sekretariat për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit, nëse do të jetë pjesë e Byrosë së Kuvendit,

sepse, nëse do të jetë, atëherë numri i anëtarëve të Byrosë së Kuvendit do të ndryshojë, pra do të jetë numër çift dhe vendimmarrja do të vështirësohet.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino ka një propozim nga kolegu Hyseni dhe zonja Hysi që nenet 4 dhe 5 të lihen të hapura, në mënyrë që ta konsultojmë si duhet me Byronë e Kuvendit, por edhe me shërbimet e Kuvendit saktësimin e kompetencave të Byrosë së Kuvendit dhe të sekretariateve përkatëse.

Po zoti Fino.

Bashkim Fino – Byroja e Kuvendit përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, dy sekretarë për buxhetin, pra kjo e thekson, në Sekretariatit për Buxhetin, kjo do 2 sekretarë dhe paska 2 sekretarë për buxhetin, një nga maxhoranca, një nga opozita. Këtë “4 sekretarë” nuk mund ta vëmë si numër, unë jam i mendimit të vihet kryetari, zëvendëskryetari, 2 sekretarët e buxhetit dhe të gjithë sekretarët e tjerë sipas nenit 5, sepse neni 5 mund të bëjë 5 sekretarë dhe të gjitha ata do të jenë, siç e tha edhe Hyseni, pjesë përbërëse e Byrosë, por, kur e vë “4 sekretarë”, i numëroi zonja Hysi, na dalin 6. Po të heqim pikën 1 të buxhetit, 1 është për procedurat e votimit, 1 për statusin e deputetët, 1 për kërkimet parlamentare dhe bibliotekën e të tjera, 1 sekretar i marrëdhënieve me jashtë. Pra 5 dhe 2 ata të buxhetit bëhen 7.

Ulsi Manja- Atëherë, zoti Fino, që ta hedhim në votim nenin 4 duhet që në pikën 2 të nenit 4 që propozohet, ne ta bëjmë “2 sekretarët për buxhetin” t’i heqim numrat dhe t’i referojmë te neni 5.

Nëse biem dakord kështu, dhe zoti Hyseni, që ishte edhe propozuesi, tërhiqet, atëherë kush është dakord me nenin 4, me korrigjimet përkatëse në pikën 2?

Dakord.

Zonja Pano, këshilltarët të mbajnë shënim korrigjimet që iu bënë pikës 2. Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenime nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 që ndryshon nenin 10. “Sekretariatet e Kuvendit”.

Në fakt, është një propozim që ka ardhur nga stafi i shërbimeve për të përcaktuar se cilat janë sekretariatet dhe me diskutimet që bëmë me kolegët kjo tashmë është e qartë.

Atëherë, kush është dakord me nenin 5?

Alket Hyseni- Këtu po shtohet një sekretariat, i cili për mendimin tim, është i pakonsultuar gjerësisht. Ka një prije për t’iu përgjigjur sfidave të kohës rreth transparencës dhe jemi dakord, por kjo do të zgjidhet me një sekretariat të posaçëm apo do të zgjidhet me atashim pranë sekretariateve konkrete? Për shembull Sekretariati për Procedurat e Votimit

mund të përfshijë fare mirë transparencën, ndërkohë teknologjia e informacionit mund të jetë në një nga sekretariatet e tjera, ose tek i njëjti. Nuk është i domosdoshëm mendimi im për të qenë sekretariat i ri po them, kjo duhet diskutuar në Byro, por unë mendoj ta konsultojmë.

Ulsi Manja – Çfarë dëmi i bën të shtohet edhe Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit?

Alket Hyseni- Po shtojmë shumë sekretariate dhe shpenzime.

Ulsi Manja- Po brenda për brenda Kuvendit janë këto, nuk kanë shpenzime.

Alket Hyseni – Po si nuk ka shpenzime, a paguhen mbledhjet?

Ulsi Manja- Byroja e Kuvendit është tjetër gjë.

Në dijeninë time, shtimi i këtij sekretariati a ka kosto financiare?

Mimoza Pano- Jo nuk ka kosto financiare, përbëhet nga deputetë të Kuvendit, dhe do të mbikëqyrë veprimtarinë e Shërbimit të Teknologjisë dhe Informacionit në Kuvend dhe gjithë punën që bën ky shërbim sa i përket hartimit të projektbuxhetit afatmesëm të buxhetit të vitit. Do të japë mendimet e veta me qëllim që, kur të shkojë buxheti i këtij shërbimi në Byro të jetë i konsultuar me sekretariat.

Ulsi Manja– Zoti Hyseni, për sa kohë nuk ka kosto financiare kjo rrit transparencën. Ky sekretariat është edhe i domosdoshëm.

Alket Hyseni – Unë isha skeptik, sepse nuk është diskutuar fare në Byronë aktuale të Kuvendit, megjithatë nuk jam kundër. Mendimi personal është që nuk është i domosdoshëm. Ne kemi shumë sfida, nuk kemi vetëm transparencën. Po të kishim për çdo sfidë nga një sekretariat, më duket se nuk dalim asgjëkund. Ka një traditë, kaq sekretariate ka pasur ky parlament 29 vjet. Lëreni ta bisedojmë në Byro.

Ulsi Manja- Ju, shumica e deputetëve që jeni në Byro, jeni edhe në Komisionin e Ligjeve.

Bashkim Fino- Unë jam plotësisht dakord për Sekretariatin e Buxhetit, jam dakord me Sekretariatin e Procedurave të Votimit. Jam dakord me Sekretariatin e Statusit të Deputetit, jam dakord për kërkimet parlamentare, bibliotekën, jam dakord edhe për Sekretariatin për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit. Po pse duhet Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë për Kuvendin? A mund të ma thoni? Nëse ti vë sekretar për marrëdhëniet me jashtë të Kuvendit, atëherë vër edhe sekretar për marrëdhëniet publike, vër edhe sekretar sipas komisioneve. Prandaj, unë jam i mendimit që të gjitha këto sekretariate, që ekzistojnë, janë shumë të domosdoshme. Pse nuk bëhesh xheloz ti që nuk paska një sekretar që të të përfaqësojë edhe Komisionin e Ligjeve, por paska sekretar për marrëdhëniet me jashtë?

Vasilika Hysi – Të nderuar kolegë, në nenin 10 ka vetëm dy ndryshime, dy fjalë “sekretariat shkencor” thuhet “sekretariati për kërkimin parlamentar” dhe shtohet “Sekretariati për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit”. Pra, sekretariati për marrëdhëniet me jashtë me Kuvendin ka 28 vjet që funksionon. Pse është shtuar sekretariati për transparencën dhe teknologjinë e informacionit? Në Kuvendin e Shqipërisë ne kemi një program *e-parlament* dhe janë shpenzuar në legjislaturat e kaluara miliona euro për të bërë dixhitalizimin dhe deputetët të kenë para tyre gjithçka *online*, të punohet *online* me qëllim që të dihet si vjen një projektligj nga propozuesi qoftë ky Këshilli i Ministrave, 20 mijë firmëtarë apo deputetë. Kush ndërhyr në ndryshimin e ligjit a do të lërë gjurmë? Kush e ka ndryshuar, është lobuar ligji, e ka ndryshuar deputeti falë konsultimit që kanë bërë, debateve apo problemeve që kanë dalë gjatë konsultimit dhe diskutimit publik në parlament e të tjera?

E treta, Kuvendi i Shqipërisë dhe qeveria shqiptare si të gjitha parlamentet e tjera është në kuadër të nismës për një qeverisje të hapur, çka kërkon që ne duhet të rrisim transparencën për qytetarët dhe në transparencë nuk janë thjesht vizitat e vizitorëve në faqen e Kuvendit të Shqipërisë. Në faqen e Kuvendit, e cila deri më sot është një faqe që pasqyron aktivitetet, por jo veprimtarinë reale të deputetëve, të debateve nëpër komisione, të gjurmojë ligjet, se si vjen një ligj dhe si miratohet në fund, për ta ditur kush bëri çfarë në një ligj, atëherë është e nevojshme që të ketë një sekretariat, por të gjitha këto kërkojnë kosto, investime dhe teknologji për t’u përmirësuar.

Propozimi që bëri kolegu Hyseni, që ky sekretariat të bashkohet me sekretariatin për procedurat dhe votimet, nuk ka lidhje me procedurën dhe votimin e deputetëve, por ka lidhje me gjithë veprimtarinë që bën Kuvendi në të gjitha ditët e vitit. Ne kemi një propozim të IPA-s, megjithatë drejtoreshat që janë pranishme këtu, meqenëse propozimi ka ardhur nga Shërbimi i Bibliotekës dhe Kërkimi Parlamentar dhe nga projekti le të na japin më shumë argumente për Sekretariatin për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit.

(Diskutime pa mikrofon)

Kuvendi duhet të rrisë transparencën...

(Diskutime pa mikrofon)

Është bërë se është projekti IPA, ne jemi duke folur...

(Diskutime pa mikrofon)

IPA është Bashkimi Europian, nuk është shoqatë. Jemi duke folur për asistencën që na dha Bashkimi Europian 3 vjet në parlament.

Ulsi Manja – Zoti Fino, keni ndonjë propozim konkret?

Bashkim Fino – Po, propozimi im është, çfarë është ky nen që ta kuptojmë, Vasilika? Ky nen është për disa sekretarë deputetësh që mbulojnë buxhetin, sekretariatin e procedurës së votimit, sekretariatin për statusin e deputetit, sekretariatin për kërkimin parlamentar. Jam dakord me ty Vasilika, për pikën e fundit, për transparencën dhe teknologjinë, sepse drejt asaj duhet të shkojmë. Propozimi që unë kam është: çfarë duhet një deputet-sekretar për marrëdhëniet me jashtë kur ne në parlamentin shqiptar kemi një superdrejtori të Marrëdhënieve me Jashtë që përgatit dosjet (kështu më thatë më parë që e përgatit stafi të gjitha materialet për të kaluar buxheti)? Këtu është fjala për buxhetin, Vasilika. Të gjithë që janë këtu, në Byro, kanë të bëjnë me problematikën e funksionalitetit dhe të buxhetit të parlamentit shqiptar, pra tonën të 140 deputetëve, si dhe të administratës këtu, për këtë është kjo.

Nëse ti më vë mua një sekretar-deputet për marrëdhëniet me jashtë kur ke një komision, kur ke edhe një drejtor të marrëdhënieve me jashtë super të ngarkuar, atëherë unë dua të vihet edhe një sekretar për çështjet ligjore, sepse kështu hapet oreksi për të gjitha. Të vëmë edhe një sekretar për arsimin dhe shkencën e kështu me radhë.

Unë mendoj të jemi sa më konciz, sepse këto i bëjmë vetë, mund ta heqim dhe ta vëmë si të duam sekretarin. Propozimi im është që të ngelen të gjithë siç janë dhe të heqim vetëm sekretarin e Marrëdhënieve me Jashtë me Kuvendin, sepse ka një drejtor për këtë, prandaj nuk ka pse të jetë një sekretar për këtë gjë. Nëse do ta lini, atëherë për mua dhe për ty është turp, Vasilika, të mos kemi një sekretar të çështjeve ligjore, prandaj do të propozoj një sekretar për çështjet ligjore dhe të jetë këtu se s'bën.

Ulsi Manja – Dakord, zoti Fino.

Bashkim Fino – Kjo është për buxhetin dhe nuk ka lidhje fare me atë punë. Kjo është çështja ime, unë kam të drejtë të diskutoj dhe për këtë ju bëra një propozim konkret.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Fino!

Ju lutem, zoti Fino, kjo pjesë, nëse nuk gjejmë mirëkuptim dhe dakordësi për ta dëgjuar njëri-tjetrin...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, duhet të jemi korrekt!

(Diskutime pa mikrofon)

Ka dy vjet që këto ndryshime të Rregullores janë në Kuvend, edhe në Byro, madje është ngritur edhe një grup pune nga Kuvendi. Ne nuk jemi këtu në mbledhje pune, por jemi për të definuar ato nene dhe sugjerime konkrete që dalin gjatë diskutimit.

Zoti Hyseni thotë pse nuk ka ardhur në Byronë e Kuvendit? Ne nga Byroja e Kuvendit e kemi marrë këtë draft. Jo më larg se javën tjetër kishim një mbledhje me Kryetarin e Kuvendit

pikërisht për ndryshimet në Rregullore dhe të gjitha organet e Kuvendit kanë marrë porosi që të japin sugjerimet e fundit në lidhje me Rregulloren.

Unë nuk jam dakord. Zoti Fino bëri një propozim që të hiqet Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë. Personalisht, pasi një votë kam, nuk jam dakord për të bërë regres për diçka që ka 20 vjet në Rregulloren e Kuvendit...

(Diskutime me mikrofon)

Problemi qëndron nëse do ta pranojmë shtesën që është bërë për Sekretariatit për Transparencën dhe Teknologjinë e Informacionit?

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, më lër ta mbaroj fjalën dhe ti mund të shtosh çfarë të duash!

Në nenin 10 janë këto sekretariate që janë dhe që kanë funksionuar pranë Kuvendit të Shqipërisë këtu e 28 vjet më parë që nga viti 1992. Diskutimi është: a biem ne dakord me propozimin që ka bërë grupi i punës për Rregulloren që krahas sekretariateve ekzistuese të shtohet edhe një tjetër? Ky është propozimi e hedhim në votim dhe mbyllet problemi.

Fjalën e ka zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Nuk është propozim, por thjesht pyetje për relatoren. Zonja Hysi, çfarë bën konkretisht sekretariati për marrëdhëniet me jashtë?

Ulsi Manja – Zonja Hysi, e ka fjalën.

Vasilika Hysi – Faleminderit për pyetjen!

Byroja e Kuvendit ka kompetenca të shumta, prandaj më lejoni t'ju lexoj atë që shtohet në pikën 7, që ndryshon: “Shqyrton dhe miraton raportin vjetor të Kuvendit të të gjithë veprimtarisë (pjesë e veprimtarisë së Kuvendit është edhe diplomacia parlamentare); raportin vjetor të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje (prandaj është edhe Sekretariati për Teknologjinë dhe Transparencën, raportin vjetor të zbatimit të rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë dhe të rekomandimeve që bëjnë institucionet, të gjitha përmbushjet e rekomandimeve dhe detyrimet që ka Kuvendi në kuadër të planit të veprimit për shkak të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, GRECO, MANIVAL e të tjera. Të gjitha këto dokumente miratohen nga Byroja, e cila ka nevojë të ketë sekretariat, njerëz, deputetë, të cilët, kur dëgjojnë përfaqësuesit e drejtorive që janë në shërbimin civil për këto problematika, do të vendosin, se, në fund të fundit, është Byroja që i miraton.

Diplomacia parlamentare është shumë e rëndësishme, kemi gjithë këto grupe miqësie, delegacione të përhershme në institucione, Këshillin Kombëtar të Integrimit Kombëtar, Komisionin e Integrimit dhe, lidhur me shqetësimin që ka zoti Fino, pse nuk krijohet një këshill

që të përfaqësojë Komisionin e Ligjeve, ky komision ka privilegjin që ka Këshillin e Legjislacionit më vete të përbërë nga 10 anëtarë, 5 nga shumica dhe 5 nga pakica.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Hysi!

Fjala për ju, zonja Pano.

(Diskutim pa mikrofon i zotit Fino)

Ju lutem, zoti Fino! Nuk mund ta marrësh fjalën sa herë të duash!

(Diskutim pa mikrofon)

Mund ta vazhdoni në kafe këtë muhabet!

Zoti Alimadhi, fjala për ju.

Adriatik Alimadhi – Unë e kam kuptuar kështu këtë, kryetar: nuk e di pse zoti Fino do që të shtohet një sekretariat, sepse këtu thuhet: “Sekretar ose Sekretariati për Kërkimin Parlamentar, Bibliotekën dhe Botimin Parlamentar e të tjerë”. Atëherë këtu nuk ka sekretar, nuk e di pse e kërkon ai.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, shkruajeni!

Është e shkruar më poshtë? Dakord!

Ulsi Manja - Zonja Pano, a keni një mendim të fundit, të lutem, para se ta hedhim në votim, pastaj deputetët të votojnë si të duan!

Mimoza Pano – Kryetar, lidhur me funksionimin e sekretariateve, në Rregullore ka një nen që parashikon çfarë bëjnë sekretariatet: “Sekretariatet e Kuvendit, që përbëhen nga deputetë, mbikëqyrin veprimtarinë e administratës së Kuvendit dhe veprimtarinë e shërbimeve të Kuvendit”. Kjo gjë përcaktohet në nenin 121, pika 3-të të Rregullores, ku thuhet: “Sekretariatet e Kuvendit mbikëqyrin punën e shërbimeve për përmbushjen e detyrave të tyre në funksion të veprimtarisë së Kuvendit dhe organeve të tij dhe kjo mbikëqyrje pastaj adresohet në Byronë e Kuvendit”.

Përpos kësaj, mund t’ju informoj se mënyra e funksionimit të sekretariateve është e rregulluar me një rregullore të brendshme, ku çdo sekretariat ka detyrat e tij.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 5, që ndryshon nenin 10, sipas propozimit të relatores? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 5, që ndryshon nenin 10.

Neni 6 që ndryshon nenin 11.

Nenet do t’i hedhim në votim pa asnjë lloj diskutimi, me përjashtim të rasteve kur ka propozime konkrete për riformulim. Ndërsa muhabete për të shtyrë kohën, nuk do të ketë!

Bashkim Fino – Ju lutem, ju kërkova leje për procedurë dhe me rregullore më takon ta marr fjalën sa herë të dua. Mund të flas?

Kur diskutohet nen për nen, që është shumë e rëndësishme, mund të bëjmë edhe diskutime. Është e vërtetë që kam bërë vërejtje, kam dhënë sugjerime dhe dua të përmirësohet edhe më shumë Rregullorja. Ku është e keqja këtu? E di ku e kemi të keqen ne, kryetar? Ne duam ta fillojmë e ta mbarojmë sa më shpejt, por kjo mund të zgjasë edhe dy ditë apo tre, dhe nuk ka asgjë të keqe. Për nene të caktuara edhe mund të nxitojmë, për shembull, këtu e mora vesh se cili është roli i sekretarit për Marrëdhëniet me Jashtë nga pyetjet që bëri Ralfi dhe nga përgjigjet e zonjës nënkryetare. Ndaj isha kundër te ky nen dhe propozova që, nëse do të jetë e mundur, të kemi edhe një sekretar për Çështjet Juridike, sepse atje ku është, është thjesht këshillimor, ndërsa këtu është vendimmarrës. Ky ishte diskutimi im dhe ju thatë jo, e doni kështu, ndaj votova kundër, por nuk jam kundër nenit 5 në tërësi dhe as kundër Rregullores në tërësi, por kjo nuk do të thotë që të mos diskutojmë për çdo nen të caktuar. Ne mund të diskutojmë dhe të shkëmbejmë mendime dhe më mirë që ka mendime, se janë të shëndetshme, e kundërta, e keni gabim nëse doni t'i kaloni me shpejtësi. Kjo është Rregullorja jonë. Nesër unë mund të marr iniciativë dhe të ta mbush mendjen ty që të jesh dakord me mua, që të ndryshojmë dy-tre pika të Rregullores. Pse ka ngelur kaq gjatë? Ka mbetur që ne të biem dakord që të hartojmë një Rregullore gjithëpërfshirëse.

Ulsi Manja - Më duket se nuk më paske dëgjuar kur hapa mbledhjen!

Në fillim thashë: nuk është qëllimi që ta përfundojmë sot dhe as brenda javës, sepse thashë, kolegë deputetë të opozitës, por jo vetëm, kanë kërkuar që për nene të caktuara të përfshihen në diskutime, por duhet të kenë sugjerime dhe propozime konkrete. Unë ju kam thënë që për nenet që kemi në tavolinë dhe që biem dakord t'i votojmë, do t'i votojmë derisa të vazhdojë mbledhja e sotme, nenet e tjera do t'i lëmë të hapura për diskutim dhe, përpara votimit në tërësi, do t'i rikthehemi duke marrë në konsideratë edhe propozimet, sepse kjo natyrë punë është në praktikën e këtij komisioni dhe nuk është hera e parë që e bëjmë këtë gjë.

Në këtë mënyrë kërkova të evitohen debatet për gjëra të caktuara, sepse, më mirë e lëmë hapur atë nen dhe i rikthehemi më vonë, sesa të ngelemi tek një nen konkret.

Jemi te neni 6.

Alket Hyseni – Do të doja të bëja një shpjegim: së pari, dua të shpjegoj që propozimi im, që nuk u hodh në votë, ishte për t'u bërë një analizë nëse është e nevojshme të kemi...

(Diskutim pa mikrofon)

Ulsi Manja - Ju lutem, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Tani, mimikë nuk mund të bëjë askush këtu. Kush do të bëjë mimikë, të dalë përjashta, se dimë edhe ne të bëjmë mimikë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti kryetar, analiza duhej bërë, thashë unë, se nuk e dija nëse e ka bërë. Më sqaroi kolegja që ka pasur një projekt të IPA-s rreth kësaj gjëje. Nuk jam njohur, por mendoj se mund të ishim njohur, unë dhe secili nga kolegët për të marrë një vendim nëse është e domosdoshme të shtojmë edhe një, të shtojmë dy, të heqim dy, ku e di unë. Pra, kjo gjë kërkonte analizë dhe unë propozova të shtyhej.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kaluat? Nuk ka problem. Unë nuk kam asgjë kundër çështjes së transparencës. Unë di që është bërë vërtet një punë kolosale edhe nga kolegja, edhe nga kolegë të tjerë, por kjo nuk na e heq të drejtën që sot, nesër ose pasnesër të mund të ndryshojmë edhe mendimet tona.

Ulsi Manja – E qartë.

Alket Hyseni – Ata, që kanë qenë në grup pune, mund të kenë qenë në të njëjtin mendim, por ka evoluar mendimi. Nuk ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Jam dakord që në grup pune.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, kam dhënë mendime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Në fakt, pse është draft i konsultuar, ka dy vjet...

E shtrova pak më parë këtë natyrë procedure që do të duhet të ndjekim në komision, se nuk është e thënë të biem dakord për të gjitha nenet, prandaj ka votim. Pra, pranohet edhe vota kundër, edhe mendimi kundër. Por, në fund të fundit, ky është libri i rregullave me të cilat punon Kuvendi i Shqipërisë dhe ne deputetët.

Unë jam dakord me të gjitha sugjerimet që ta përmirësojmë si draft, pasi gjatë kohës që e kemi pasur draftin në dorë, mund të kenë ecur përpara disa gjëra, por disa gjëra të tjera kanë nevojë të hiqen fare nga Rregullorja. Unë prandaj e thashë në fillim që projektvendimi për ndryshime në Rregullore është i hapur.

Tani, meqenëse në orën 12:00 kemi mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, zonja Hysi, a jemi në gjendje ta kalojmë nenin 6?

Vasilika Hysi – Po.

Faleminderit!

Të nderuar kolegë, unë do të doja t'ju sillja në vëmendje që secili prej jush ka marrë raportin e plotë të IPA-s (shqip-anglisht) dhe e keni në tavolinat tuaja në sallën e seancave plenare. Besoj se keni parë që keni disa botime aty sipër.

Së dyti, i keni edhe *online* të gjitha rekomandimet. Kjo është për transparencë. Janë shpërndarë nga shërbimet e Kuvendit këtu e disa muaj më parë, madje shumica prej jush e ka lënë ende në tavolinën e seancës plenare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht neni 6 është rekomandim i ardhur nga projekti i IPA-s i Bashkimit Europian në komponentin e tretë, që bën fjalë për pavarësinë financiare. Aty reflektohen dy rekomandime, pikërisht pikat 2 dhe 4 e nenit 11, që bëjnë fjalë për thirrjet dhe kompetencat e Byrosë së Kuvendit. Konkretisht, ka të bëjë me përgjegjësinë që merr Kuvendi për çështjet e buxhetit dhe të pavarësisë buxhetore.

Në pikën 2 janë shtuar dy hallka të rëndësishme.

E para, nuk do të jetë siç është sot që për buxhetin e Kuvendit vendos vetëm Byroja e Kuvendit, pastaj buxheti zbatohet, por do të vendosë Byroja dhe, pasi ka vendosur kjo e fundit, buxheti i propozuar nga sekretarët e Buxhetit dhe nga Byroja, i përcillen Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Pasi shqyrtohet dhe diskutohet në këtë komision, i përcillet për miratim seancës plenare. Kjo është një kërkesë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, të mbaroj!

Këto janë dy elemente shumë të rëndësishme. Pra, përderisa ne kërkojmë pavarësi financiare, do të ketë instrumente të kontrollit financiar shumë më të fuqishëm, nuk do t'i mbetet vetëm Byrosë, prandaj janë shtuar Komisioni i Ekonomisë dhe seanca.

Lidhur me riformulimin për nga teknika legislative, që bën kolegu Fino, pa dyshim që ne mund ta shikojmë, sepse...

(Deputeti Fino ndërhyr pa mikrofon.)

Do t'ju thosha këtë gjë, pasi, edhe ne, që e lexojmë përsëri Rregulloren tani, pasi ka fjetur gjashtë muaj, shohim që ka nevojë të rregullohet gjuha (teknika legislative), prandaj këtë diskutim e shoh si shumë të dobishëm.

Zoti Fino propozon: “Byroja vendos për buxhetin e Kuvendit sipas propozimit të bërë nga sekretarët për buxhetin dhe e përcjell në Komisionin për Ekonominë dhe Financat për ta miratuar më pas në Kuvend”.

Bashkim Fino – Të jetë pikë më vete kjo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pjesa tjetër të jetë pikë më vete.

Vasilika Hysi – Ju keni shumë të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çështja tjetër ka të bëjë me kompetencën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, unë kuptoj, por ju, burrat nuk po më lini të flas!

Ulsi Manja – Ju lutem!

Vasilika Hysi – Unë kam punuar gjatë gjithë kohës dhe nuk mërzitem që ju dëgjoj!

Ulsi Manja – Ju lutem, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Ajo që thotë zoti Fino është e vërtetë: “vendos për ankimimet në rastin e konstituimit të grupeve parlamentare, ndërsa për ankesat e grupeve për përbërjen është kompetencë tjetër”, dhe do të dalë pikë tjetër.

Kanë qenë bashkë në Rregulloren aktuale, e cila është miratuar njëzet e ca vjet më parë, që pa dyshim ka nevojë të rishikohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në vitin 2004.

Pra, kalon pikë më vete. Biem dakord me këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kalojmë te pika 4, e cila bën një ndryshim te kompetencat dhe reflekton pikërisht këtë kompetencë që i është dhënë Byrosë së Kuvendit. Pra, pjesa që e keni më të theksuar janë ndryshimet.

“Byroja e Kuvendit, në zbatim të kuadrit ligjor dhe në përmbushje të garantimit të pavarësisë organizative, funksionale dhe financiare, harton rregulla të detajuara për: a) pjesëmarrjen e deputetëve në veprimtari parlamentare (sepse nuk kemi pasur rregulla të përcaktuara); “b) trajtimin financiar të deputetëve dhe organeve të Kuvendit, në përputhje me statusin ligjor”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Organet?! Janë Byroja, Këshilli...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vijojmë me germën “c”: “Për statusin ligjor, trajtimin ekonomik dhe kriteret e punësimit të administratës së Kuvendit”, si dhe germën “ç”: “Organizimin e strukturës së shërbimeve të administratës, sipas funksioneve kushtetuese, që Kuvendi ushtron”. Kjo ishte në lidhje me pikën 4.

T’i marrim me radhë, zoti kryetar, sepse janë çështje të ndryshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Shprehem dakord.

Vasilika Hysi – Lidhur me pikën 5, varianti që ju keni përpara është riparë, pasi ne kemi një opinion të ardhur nga OSBE-ODIHR-i, por, njëkohësisht, edhe në raportin e GRECO-s është kërkuar që për masat disiplinore Kuvendi të ketë një procedurë transparente, por të ketë edhe një mekanizëm të ankimimit.

Deri sot, të nderuar kolegë, masat e rënda disiplinore i jep Byroja e Kuvendit, por nuk ka mekanizëm ankimimi ndaj vendimeve të saj.

Ka pasur një konsultim me të gjithë kolegët e grupit të punës, por edhe në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin para një viti, se si mund të adresohet ky shqetësim.

Sot që flasim, shërbimet e Kuvendit, në zbatim të rekomandimit të OSBE-ODIHR-it dhe të GRECO-s kanë sjellë një riformulim të pikës 5, duke krijuar një mekanizëm me dy shkallë për shqyrtimin, dhënien e masave disiplinore dhe për ankimin ndaj masave disiplinore. Kështu që Byroja e Kuvendit kthehet në organ apelimi i nivelit të dytë, por krijohet një mekanizëm tjetër, i cili do të japë masat disiplinore, që do të quhet Komisioni i Etikës dhe i Masave Disiplinore.

Lidhur me titullin e këtij komision duhet ta diskutojmë, sepse “masat disiplinore” nuk më pëlqen, por është një draft që nuk mund ta marrim përgjegjësinë as unë dhe as Mimoza pa e diskutuar mes nesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo këtu është vetëm neni 5, sepse ai është neni 25, kryetar.

Ulsi Manja- Ai nen do të jetë nen më vete kur të kalojmë te neni 25. Kështu që, parimisht, është një nen që e kemi diskutuar edhe me autoritetet e larta të Kuvendit, pra Kryetarin e Kuvendit, dhe kemi rënë dakord që Byroja e Kuvendit të jetë organi ankimues dhe që merr vendimin e formës së prerë për aplikimin e masave disiplinore. Në një instancë më të ulët, kur të kalohet te neni përkatës, ka një propozim që të ngrihet një komision, i cili do të quhet Komisioni i Etikës dhe Masave Disiplinore me atë formulim që ne do ta diskutojmë në ditët kur të jetë shqyrtimi nen për nen i Rregullores së Kuvendit. Një gjë është e sigurt, që Byroja e Kuvendit do të jetë instanca eprorë, sepse është organi më i lartë. Ne këtu përmbushim

edhe një rekomandim të GRECO-s, që për masat disiplinore që merren ndaj deputetëve, të garantohet një shkallë ankimi, por që të mbetet brenda për brenda vendimmarrjes së Kuvendit dhe jo të dalë jashtë, si për shembull, në Gjykatë Administrative, sepse nuk ndryshon kapitulli “Masa disiplinore. Pra, kapitulli i “Masave Disiplinore”, masat që jepen ndaj deputetit ngelen po ato që janë në Rregulloren e Kuvendit.

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Jam dakord me këtë, sepse në draftin që ka ardhur me email ka qenë ndryshe dhe ka qenë i konceptuar gabim.

Unë kam propozim për pikën 4, të “Byroja e Kuvendit” “kompetencat”, duhet shtuar një pikë pas germës “ç”, kur thuhet: “Hartohen rregullat e detajuara për veprimtarinë e sekretariateve”. Deri sot e ka bërë, por të pashprehur.

Ulsi Manja- Është e drejtë. Duke qenë se ne kemi 5 sekretariate...

Alket Hyseni –Unë dua që në rregullore në secilin sekretariat duhet të rezervohet e drejta që në mbledhjet e kaluara të shtojmë një dispozitë, që të jetë e rregulluar dhe të paraqesë se çfarë detyre bën sekretariati. Çfarë kuptimi ka nëse nuk është e SHKRUAR në Rregullore?! Këto janë organe të rëndësishme.

Ulsi Manja- Shënojeni që pas germës “ç” të shtohet propozimi i zotit Hyseni, që të ketë rregulla të caktuara për mënyrën e funksionimit të sekretariateve, por, nëse kemi hapësirë në nenet më pas, të kemi një parashikim në Rregullore edhe për detyrat e sekretariateve, që do të ishte një vlerë e shtuar për Rregulloren. Pra, është shumë e nevojshme që të dihet se kush dhe çfarë do të bëjë secili këtu, pavarësisht se ka një praktikë të konsoliduar në Kuvend.

A ka sugjerime për nenin që po diskutojmë?

Vasilika Hysi- Dua të jap një vlerësim të propozimit të kolegut. Unë jam dakord, sepse më ka rënë në sy që Rregullorja rregullon vetëm Sekretariatin për Buxhetin dhe nuk thotë me detaje ose të ketë një nen të veçantë siç është për sekretariatet e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A do të mbetet t’i caktojë Byroja detajimin apo do t’i caktojë me nene të reja të shtuara në Rregullore, ashtu siç është rregulluar Sekretariati për Buxhetin?

Zoti kryetar, në vijim ka një tjetër ndryshim në pikën 6, ku thuhet: “Byroja e Kuvendit emëron, me propozim të Kryetarit të Kuvendit sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, sipas rregullave të legjislacionit në fuqi”. Pse? Ndryshimi këtu është se Kryetarit të Kuvendit i çoheshin 3 kandidatura, kjo bie ndesh me ligjin “Për nëpunësin civil”. Rregullorja është bazuar në ligjin e vitit 1999, ligji i ri për nëpunësin civil i vitit 2013 nuk lejon që titullari të përzgjedhë 1 ndër 3 kandidatët. Pra, në këtë kuadër, ky është ndryshimi.

Gjithashtu, ndryshon pika 7, ku thuhet se cilat janë raportet që miraton Byroja e Kuvendit. Byroja e Kuvendit miraton disa raporte. Unë u kam kërkuar shërbimeve të Kuvendit që për germën “c” të shikojë nëse në bazë të vendimit nr. 49/2017 të mekanizmit ndërinstytucional, Byroja e Kuvendit ka detyrim të miratojë edhe ndonjë raport lidhur me zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese të krijuara me ligj. Pra, kjo duhet shtuar, kurse pjesa tjetër është në rregull.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Pano!

Mimoza Pano – Më falni, zoti kryetar, por duhet të japë një përgjigje edhe për çështjen që ngriti zoti Hyseni dhe për çështjen që ngriti relatorja.

Për sa u përket sekretariateve, meqenëse ju informuam, me vendim Byroje është miratuar Rregullorja e funksionimit të sekretariateve, kjo gjë evidentohet edhe në nenin përkatës të Rregullores, në nenin 10, pika 3, ku thuhet: “Sekretarët e Byrosë së Kuvendit, në përputhje me detyrat e caktuara nga Byroja e Kuvendit, drejtojnë sekretariatet e Kuvendit”. Tani ose do të bëjmë ndryshimin edhe te ky nen ose çfarë funksionon dhe do ta futim komplet në Rregullore, ose do ta lëmë kështu siç e kemi dhe do të shtojmë pikën që propozoi zoti Hyseni te pika 4.

Ulsi Manja – E kuptova logjikën.

Zonja Pano, meqenëse Byroja e Kuvendit miraton me vendim rregullat e funksionimit të sekretariateve, kjo kompetencë t’i lihet Byrosë, pra nuk kemi pse e detajojmë imtësisht. Megjithatë....

(Diskutime pa mikrofon)

Urdhëroni!

Alket Hyseni – Zoti kryetar, kërkesa nuk ishte t’u japë detaje, por, sikurse ka gjetur një rregullim, ndoshta më të zgjeruar sa duhet, Sekretariati për Buxhetin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, kjo është çështje konsensusi, ne jemi konsensusi këtu. Për buxhetin, sepse ju jeni kontradiktorë, pse është rregulluar në Rregullore dhe nuk i është lënë asaj kompetence, kurse sekretariatet e tjera nuk përmenden fare? Tani duhet të ruajmë një teknikë legjislative: ose merrini dhe nuk i kemi fare në Rregullore asnjë sekretariat. Kjo gjë nuk ka sens, e keni gabim, se të paktën qëllimi i sekretariatit duhet të jetë në Rregullore. Pra, duhet thënë sekretariati filan mbulon këtë fushë dhe më pas detajet të veprimtarisë mbulohen me Rregullore, pra si thirret, si mblidhet, si raporton. Këto mund të jenë në rregulloren e veçantë, por në këtë Rregullore duhet të jetë një paragraf të paktën për secilin sekretariat dhe kjo nuk ka nevojë më për diskutim. Kjo është minimalja.

Ulsi Manja – Jam dakord që në këtë nen të Rregullores të vihet një çelës, por na duhet një propozim konkret, në kuptimin që Rregullorja e posaçme për funksionimin e sekretariateve, që miraton Byroja e Kuvendit, të ketë një referencë tek ajo germë që do të shtojmë këtu. Pra, me aq sa unë kuptoj, propozimi i kolegut Hyseni është që në këtë nen të Rregullores ne të parashikojmë se cilat janë funksionet e sekretariateve kryesore, ndërsa rregullat e funksionimit të sekretariateve të miratohen nga Byroja. Gjejeni formulimin konkret dhe ta shtojmë. E lëmë edhe të hapur, nuk ka problem.

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Neni 6, pika 7, Vasilika ka thënë: “Byroja e Kuvendit miraton raportin vjetor të Kuvendit jo më vonë se 31 mars të vitit pasardhës”. Kjo i mbyll. Të gjitha të tjerat që ke vendosur më pas, janë në funksion të kësaj. Në qoftë se thua: “miraton raportin vjetor të Kuvendit jo më vonë se 31 mars i vitit pasardhës”, kjo i ezauron të gjitha.

Me poshtë thua: b) “Raportin vjetor të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje”. Hajde gjeje se çfarë është kjo!

Më poshtë thua: “Raportin vjetor të shkallës së zbatimit të rezolutave e të tjera”. Po, sepse vijnë institucionet që raportojnë këtu, bëjnë një rezolutë, flasin në Kuvend; ne diskutojmë në Kuvend, miratojmë rezolutën. Pra, kjo është pjesë e raportit vjetor të Kuvendit. Të gjitha pikat tjera që janë më poshtë... Pika e fundit mund të vihet: “Dokumentet e mësipërme publikohen në faqen zyrtare”, pra për këtë jam dakord.

Unë them: “Byroja e Kuvendit miraton raportin vjetor të Kuvendit jo më vonë se 31 mars i vitit pasardhës dhe dokumentet vihen në dispozicion në faqen zyrtare.” Të gjitha pikate tjera janë pjesë e raportit të madh, qoftë pjesëmarrja e publikut, qoftë çështja e rezolutave, pra janë pjesë e këtij raporti. Në qoftë se ti bën një raport për Kuvendin dhe thua se çfarë veprimtarie ka bërë Kuvendi vitin e kaluar, natyrisht, ti në atë raport do të thuash se kanë ardhur të gjitha institucionet dhe kanë raportuar, kanë bërë këtë rezolutë e të tjera. Në atë raport do ta thuash. Iku mbaroi, ja ku e ke. Unë mendoj që të mos shtojmë kot ujera, Kjo që thashë është më tepër për rregullim. Pra, vendos germën “a” të pikës 7 dhe fjalinë e fundit që bëhet publike.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Hysi, edhe unë kam merakun tim, në vazhdim të asaj që tha kolegu Fino. Nëse do të pranojmë propozimin e kolegut Fino dhe ta lëmë vetëm “miraton raportin vjetor të Kuvendit jo më vonë se data 31 mars të vitit pasardhës”, ne jo vetëm i përmbushim të gjitha, por shmangim edhe disa konfondime të tjera. Për shembull, mua më duket se një parashikim i germës këtu cenon edhe kompetencat e komisioneve të përhershme të Kuvendit. Për shembull, çfarë pune ka Byroja e Kuvendit të miratojë raportin vjetor të shkallës të zbatimit të rezolutave

të Kuvendit për vlerësimin e institucioneve kushtetuese dhe atyre të rregulluara me ligj të veçantë, kur ajo është kompetencë direkte e Komisionit të Ligjeve dhe e seancës plenare?! Çfarë pune ka një organ i Kuvendit të bëjë vlerësimin e një institucioni kushtetues dhe të krijuar me ligj, që është drejtpërsëdrejti atribut i kësaj tryeze? Pra, unë them që propozimi i zotit Fino që “Byroja miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Kuvendit jo më vonë se data 31 mars të vitit pasardhës dhe të publikohen në faqen zyrtare” i shmang të gjitha implikimet e tjera kushtetuese. Tani ma merr mua këtë Byroja e Kuvendit, një organ ad hoc me 5 deputetë?! Atëherë, çfarë vlere ka seanca dëgjimore dhe miratimi i rezolutës për një institucion kushtetues dhe të krijuar me ligj, kur çdo datë 31 mars një organ tjetër atje i Kuvendit do të gjykojë vendimmarrjen e këtij komisioni, që reflekton përbërjen pozitë-opozitë?!

Urdhëroni!

Alket Hyseni – Mos harroni që kemi Shërbimin e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, i cili bën një raport dhe ky është qëllimi, nuk është qëllimi që të kalojë në procedurën e miratimit të rezolutave. Byroja është organi më i lartë mbikëqyrës i të gjitha shërbimeve të Kuvendit dhe, për sa kohë që ka nevojë edhe kjo fushë për t’u mbikëqyrës, nuk është ndonjë gjë e keqe të jete ajo.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Diskutimi juaj me atë të zotit Fino ka një ndryshim të madh. Zoti Fino kishte shqetësimin që raporti vjetor i Kuvendit si koncept i përmbledh, ju keni një koncept tjetër dhe thoni se nuk duhet të jetë fare kjo detyrë. Unë mendoj se duhet të jetë. Kjo po e po, por edhe çdo planveprimi i Kuvendit të jetë një kompetencë më vete e Byrosë. Planet e veprimit nuk do t’i miratojmë në komision, do të jetë Byroja, më pas vendoset nëse, sipas rastit e sjell te sekretari i Përgjithshëm planet e veprimit. Mund ta rregullojmë si formulim. Jam dakord që raporti vjetor i detajuar duhet të jetë, por kjo do të jetë brenda raportit.

Ulsi Manja – Të lutem, zoti Hyseni,

Nuk kemi këndvështrime të ndryshme.

Alket Hyseni – Më lini ta mbaroj, kryetar!

Nëse do ta heqim si pikë “c”, duhet të jemi të sigurt që kjo të involvohet në raportin vjetor të Kuvendit, por a jemi të sigurt për këtë?

Ulsi Manja – Metodologjinë e hartimit të raportit vjetor, si do të jetë raporti vjetor, le ta përcaktojnë organet e Kuvendit, nëse do të përfshihet apo jo dhe, se çfarë do të përfshihet. Madje, në raportin vjetor të Kuvendit mund të fusni çdo lloj rubrike, mund ta bëni të detajuar, por të shkruhet në Rregulloren e Kuvendit që miraton raportin vjetor të shkallës së

zbatimit të rezolutave të Kuvendit, kur ajo është atribut i komisioneve të përhershme të Kuvendit, kjo ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cilin raport? Raportin e institucioneve kushtetuese.

Alket Hyseni – Raportet e secilit prej tyre, por jo një raport të Kuvendit.

Ulsi Manja – Po unë nuk miratoj raportet e Kuvendit, por ato të institucioneve kushtetuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër. Çfarë je duke thënë?

Zoti Fino,

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, se do ta mbyllim këtë mbledhje, sepse kemi edhe mbledhjen e Këshillit të Mandateve. Çdo veprimtari e organeve të Kuvendit i nënshtrohet votimit në seancë plenare. Mbi votimin e seancës plenare nuk ka më autoritet tjetër.

Zonja Hysi për një konsideratë të fundit, se do ta lëmë të hapur këtë pikë.

Vasilika Hysi – Unë sugjeroj që të lihet e hapur, por jam dakord me propozimin e zotit Hyseni.

Kolegë të nderuar,

Kuvendi i Shqipërisë ka një strategji të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe ka një detyrim të një strategjie të miratuar me vendimin e vet që të ketë një raport vjetor të posaçëm për pjesëmarrjen me publikun, ku janë 6-7 elemente, nuk është e gjithë veprimtaria e Kuvendit.

E dyta, ne kemi një vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 49, të vitit 2017 “Për monitorimin sistematik të ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Moza, të flasim pak!

Ulsi Manja – Ta kishin shërbimet e Kuvendit këtë zell për punë, kaq sa e keni në këtë komision do të ishim një shkallë më lart.

Vasilika Hysi – Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar me vendimin nr. 49, të vitit 2017 një plan veprimi. Ai ka ngritur një mekanizëm ndërinstitutional për monitorimin sistematik të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura. Ajo që unë thashë në fillim dhe ju e

debatuat, sepse nuk e dëgjuat, ishte se për pikën “c” u lashë detyrë shërbimeve ta verifikojnë në Fletoren Zyrtare, nëse ka detyrim që të ketë një raport. Ka një raport, se Kryetari raportoi në Kuvend. Atë do ta miratojë Byroja fillimisht dhe më pas do të shkojë në seancë. Unë e lashë këtë detyrë, para se ju të nisnit diskutimin.

E treta, zoti kryetar, lidhur me rezolutat, nuk flitet për të miratuar rezolutat. Ne kemi një Shërbim të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura. Ai është shërbimi më i rëndësishëm në Kuvendin e Shqipërisë, i cili merr raporte mujore dhe bën një raportim të zbatimit të të gjitha rezolutave, që kalon Kuvendi. Ai thotë nëse Avokati i Popullit është përgjegjës në kohë, apo një institucion tjetër nuk është përgjegjës, pra nuk merret me përmbajtjen, por është thjesht mënyra e kontrollit sistematik që ky shërbim bën, nëpërmjet raporteve 1-mujore, 3-mujore etj.

A ta lëmë të hapur këtë nen?

Ulsi Manja – Zonja Hysi, unë jam dakord për ta lënë të hapur këtë pikë të nenit 6, por me sugjerimin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Lëre, se pika “c” e këtij neni ka nevojë të qartësohet!

Zonja Pano,

Zoti Fino a do ta mbyllim këtë?

Do ta mbyllim këtu. Neni 6 do të lihet i hapur dhe ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Hysi, të qartësohet në pikën “c” që Byroja e Kuvendit do të monitorojë organet e veta, por jo seancën plenare. Seancën plenare nuk e monitoron dot askush, as ne.

Në mënyrën si është formuluar nuk flitet për shërbimin, por flitet për shkallën e shërbimit të rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga kush?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po kush e bën këtë vlerësim? Këtë do ta bëjë Byroja e Kuvendit apo Drejtoria e Shërbimit të Monitorimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, thuaj: raportin e Drejtorisë së Shërbimit të Monitorimit.

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Nenin 6 nuk e kemi votuar. Shqyrtimin do ta vazhdojmë në mbledhjet e radhës.

MBYLLET MBLEDHJA